



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

DEPARTAMENTI PËR BASHKËPUNIM DHE ZHVILLIM RAJONAL

Trendet e të hyrave vetanake për periudhën 2013-2015
në Komunat e Republikës së Kosovës

Qershor 2016

Përmbajtja

1. Hyrje	3
2. Pavarësia Financiare e Komunave.....	3
3. Baza ligjore për rregullimin e të hyrave vetanake	4
4. Planifikimi i të hyrave vetanake	4
5. Mbledhja e të hyrave vetanake	5
5.1 Tatimi në pronë	8
5.2 Të hyrat nga veprimtaritë afariste	9
5.3 Të hyrat nga Dokumentet e Gjendjes Civile.....	9
5.4 Të hyrat nga regjistrimi i automjeteve	9
5.5 Të hyrat nga regjistrimi i trashëgimisë	10
5.6 Të hyrat nga shfrytëzimi i pronës publike	10
5.7 Të hyrat nga participimet në Arsim dhe Shëndetësi.....	10
5.8 Të hyrat tjera	10
6. Mbledhja e të hyrave vetanake krahasuar me planifikimin	11
7. Të hyrat indirekte të komunave	12
8. Bartja e të hyrave vatanake.....	13
9. Konkluzione dhe Rekomandime	14
10. Referencat	15

1. Hyrje

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal bazuar në planin e punës për vitin 2016 ka përgatit dokumentin "Trendet e të hyrave vetanake për periudhën 2013-2015 për komunat e Republikës së Kosovës".

Ky dokument shpalos lëvizjet e planifikimit, realizmit dhe krahasimit të të hyrave vetanake për tri vitet e fundit, si dhe qet në pah gjendjen reale të të hyrave vetanake, qoft atyre të mbledhura nga komuna pra të hyrave direkte, qoftë të atyre të mbledhura nga niveli qëndror e që transferohen në komuna si të hyra indirekte.

Qëllimi i këtij dokumenti është shpalosja e gjendjes aktuale të të hyrave vetanake dhe të rekomandoj hapa për përmirësimin/ rritjen e të hyrave vetanake në komuna.

2. Pavarësia Financiare e Komunave

Të hyrat vetanake të komunave janë mjete financiare që mblidhen nga komuna, në emër të shërbimeve të ofruara për qytetarë të cilat duhet bazuar në rregulloret komunale për tarifa, ngarkesa dhe gjoba, e të cilat bëhen pjesë përbërëse me një mesatare rreth 16 % e buxhetit komunal.

Pra shihet se varshmëria financiare e komunave nga grandet e qeverisë është ende e madhe me rreth 84%.

Komunat e Kosovës kanë të drejtë të kenë burime të mjaftueshme financiare, me të cilat mund të disponojnë lirshëm gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre komunale në përputhje me ligjet e zbatueshme të Kosovës. Burimet financiare komunale do të jenë të barasvlershme me kompetencat komunale të përcaktuara në Kushtetutë dhe në LVQL.

3. Baza ligjore për rregullimin e të hyrave vetanake

Ligji Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale;

Ligjit nr. 03/L-049 Për Financat e Pushtetit Lokal;

Ligji nr 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi;

Rregulloret komunale për tarifa ngarkesa dhe gjoba.

4. Planifikimi i të hyrave vetanake

Bazuar në ligjet vjetore të buxhetit komunat e Republikës së Kosovës planifikojnë të hyrat vetanake, në mënyrë që të vlerësojnë nivelin e burimeve vetanake në dispozicion për të financuar shpenzimet e nevojshme nga këto të hyra. Në mënyrë që të planifikohen të hyrat reale, komunat kanë nevojë për sa më shumë informata të sakta dhe në kohë për bazën tatimore dhe efektin e ndryshimeve legislative. Meqenëse llojet e tarifave, ngarkesave dhe gjobave, të caktuara në procesin buxhetor komunal janë të përcaktuara në legjislacion, kjo kërkon nga komunat të përcjellin rrjedhën e këtyre të hyrave, të analizojnë faktorët që ndikojnë në vëllimin e të hyrave dhe të shiqojnë mundësin e avancimit të tyre në aspektin e rritjes së vazhdueshme.

Komunat / Viti	Planifikimi i të hyrave			Krahasimi sipas viteve i shprehur në %			Mesatarja
	2013	2014	2015	Krahasimi 2014/13	Krahasimi 2015/14	Krahasimi 2015/13	
Glogovc	1,000,000	1,050,000	1,200,874	5.0	14.4	0.1	9.7
Fushë Kosovë	1,500,000	1,729,040	1,822,756	15.3	5.4	20.1	10.3
Lipjan	1,700,000	1,166,927	1,342,336	-31.4	15.0	21.5	-8.2
Obiliq	794,000	735,000	811,716	-7.4	10.4	-21.0	1.5
Podujevë	1,350,000	1,417,500	1,597,592	5.0	12.7	2.2	8.9
Prishtinë	21,757,920	24,318,250	27,162,611	11.8	11.7	18.3	11.7
Shtime	390,000	409,500	445,503	5.0	8.8	24.8	6.9
Graçanicë	1,150,000	1,455,677	1,501,093	26.6	3.1	14.2	14.9
Dragash	420,000	441,000	487,030	5.0	10.4	30.5	7.7
Prizren	6,119,080	6,425,034	8,275,080	5.0	28.8	16.0	16.9
Rahovec	950,000	997,500	1,099,014	5.0	10.2	35.2	7.6
Suharekë	1,783,000	1,917,102	2,117,200	7.5	10.4	15.7	9.0
Malishevë	750,000	787,500	755,908	5.0	-4.0	18.7	0.5
Mamushë	60,000	63,000	64,869	5.0	3.0	0.8	4.0
Deçan	600,000	630,000	636,892	5.0	1.1	8.1	3.0
Gjakovë	2,900,000	3,045,000	3,026,311	5.0	-0.6	6.1	2.2
Istog	900,000	945,000	1,014,149	5.0	7.3	4.4	6.2

Klinë	800,000	840,000	857,767	5.0	2.1	12.7	3.6
Pejë	2,900,000	3,045,000	3,394,551	5.0	11.5	7.2	8.2
Junik	85,000	89,250	91,567	5.0	2.6	17.1	3.8
Leposaviq	15,000	17,300	42,888	15.3	147.9	7.7	81.6
Mitrovicë Jugore	2,202,320	2,312,436	2,117,292	5.0	-8.4	185.9	-1.7
Skenderaj	750,000	599,777	748,155	-20.0	24.7	-3.9	2.4
Vushtrri	1,550,000	1,652,000	1,675,327	6.6	1.4	-0.2	4.0
Zubin Potok	15,000	15,750	42,888	5.0	172.3	8.1	88.7
Zveçan	10,000	12,400	42,888	24.0	245.9	185.9	134.9
Mitrovicë Veriore	97,680	105,400	90,066	7.9	-14.5	328.9	-3.3
Gjilan	3,600,000	3,780,000	3,859,953	5.0	2.1	-7.8	3.6
Kaçanik	600,000	630,000	695,757	5.0	10.4	7.2	7.7
Kamenicë	890,000	934,500	986,433	5.0	5.6	16.0	5.3
Novobërdë	124,000	185,328	204,672	49.5	10.4	10.8	29.9
Shtërpcë	290,000	304,500	336,282	5.0	10.4	65.1	7.7
Ferizaj	3,926,000	3,807,300	4,204,689	-3.0	10.4	16.0	3.7
Viti	870,000	913,500	1,008,847	5.0	10.4	7.1	7.7
Partesh	40,000	42,000	46,384	5.0	10.4	16.0	7.7
Hani i Elezit	350,000	242,949	256,258	-30.6	5.5	16.0	-12.6
Klllokot	75,000	80,000	86,849	6.7	8.6	-26.8	7.6
Ranillug	80,000	84,000	92,768	5.0	10.4	15.8	7.7
Totali	63,394,000	67,226,420	74,243,215	6.0	10.4	16.0	8.2

Tabela 1. Paraqitja tabelare e planifikimit të të hyrave vetanake në periudhën 2013 -2015 sipas ligjit dhe trendet e rritjes/zoogëlimit

Planifikimi i të hyrave për periudhën 2013-2015 ka rritje nga viti në vit dmth. planifikimi për vitin 2014 është për 6.0% më i lartë se në vitin 2013; ndërsa në vitin 2015 është për 10.4% më i lartë se në vitin 2014, periudha nga 2013 në vitin 2015 është më i lartë për 16.0%.

Në përgjithësi mesatarja e planifikimit të të hyrave për komunat e Republikës së Kosovës për periudhën 2013-2015 është ngritur për 8.2%(shih tabelën nr.1).

5. Mbledhja e të hyrave vetanake


Është e rëndësishme që të hyrat e grumbulluara nga komunat të rikthehen tek qytetarët, në formën më të mirë të mundshme të ofrimit të shërbimeve sa më të mirë dhe më cilësorë pra, të ju dëshmohet qytetarëve se menaxhimi i mjeteve të tyre financiare është transparent dhe përdoret për shërbime sa më afër qytetarëve. Mbledhja në vitet 2013;

2014 dhe 2015 ka shënuar rritje nga viti në vit, ku në vitin 2014 ka një rritje prej 0.5% krahasuar me vitin 2013; në vitin 2015 ka një rritje prej 1.6% krahasuar me vitin 2014; ndërsa nëse shikojmë periudhën 2013 -2015 ka rritje prej 2.1%;

Mesatarja e të gjitha llojeve të të hyrave për periudhën 2013-2015 është 1.1% (shih tabelën nr.2).

Trendet e mbledhjes së të hyrave vetanake sipas strukturës							
Të hyrat vetanake	viti			krahasuar me vitet paraprake shprehur%			
	2013	2014	2015	2014/13	2015/14	2015/13	mesatarja
Të hyrat nga tatimi në pronë	16,119,339	20,411,152	19,914,321	26.6	(2.4)	23.5	12.1
Të hyrat nga regjistrimi i automjeteve	2,910,060	2,916,238	3,021,391	0.2	3.6	3.8	1.9
Të hyrat komunale për leje ndërtimi	15,979,303	11,136,199	12,020,331	(30.3)	7.9	(24.8)	(11.2)
Të hyrat nga regjistrimi i Trashegimis	1,613,644	1,590,502	1,460,820	(1.4)	(8.2)	(9.5)	(4.8)
Të hyrat nga ndërrimi i Destinimit të tokës Tokës	1,584,156	2,336,036	2,022,868	47.5	(13.4)	27.7	17.0
Të Hyrat nga Dokumentet e Gjendjes Civile	2,392,101	2,672,299	3,000,017	11.7	12.3	25.4	12.0
Të hyrat nga veprimtaritë afariste	1,729,336	1,592,462	1,481,562	(7.9)	(7.0)	(14.3)	(7.4)
Të hyrat nga shfrytëzimi i pronës publike	2,593,554	2,935,795	2,625,012	13.2	(10.6)	1.2	1.3
Të hyrat nga participimet në Arsim dhe Shendetësi	4,162,199	4,198,955	4,033,546	0.9	(3.9)	(3.1)	(1.5)
Të hyrat e tjera	3,088,709	2,662,902	3,705,428	(13.8)	39.1	20.0	12.7
Totali	52,172,402	52,452,540	53,285,296	0.5	1.6	2.1	1.1

Tabela 2. Paraqitja tabelare e inkasimit të të hyrave vetanake në periudhën 2013 -2015 dhe trendet e rritjes/ zvogëlimit



Grafikoni 1. Mesatraje e mbledhjes së të hyrave për periudhën 2013-2015

Shikuar për nga rëndësia e të hyrave sipas pjesëmarrjes shihet se përveq të hyrave nga tatimi në pronë, që janë një e hyrë kryesore dhe më e rëndësishme deri më tani, janë edhe të hyrat nga lejet e ndërtimit që kanë një pjesëmarrje të konsiderueshme në të hyrat vetanake (shih trafikonin nr.1).

Pjesmarrja në të hyrave vetanake (%)

	2013	2014	2015
■ Të hyrat nga tatimi në pronë	30.9	38.9	37.4
■ Të hyrat nga regjistrimi i automjeteve	5.6	5.6	5.7
■ Të hyrat komunale për leje ndërtimi	30.6	21.2	22.6
■ Të hyrat nga regjistrimin i Trashegimis	3.1	3.0	2.7
■ Të hyrat nga ndërrimi i Destinimit të tokës Tokës	3.0	4.5	3.8
■ Të Hyrat nga Dokumentet e Gjendjes Civile	4.6	5.1	5.6
■ Të hyrat nga veprimtaritë afariste	3.3	3.0	2.8
■ Të hyrat nga shfrytëzimi i pronës publike	5.0	5.6	4.9
■ Të hyrat nga participimet në Arsimit dhe Shendetësi	8.0	8.0	7.6
■ Të hyrat e tjera	5.9	5.1	7.0

Grafikoni 2. Pjesmarrja e të hyrave sipas strukturës në të hyrat vetanake direkte

5.1 Tatimi në pronë

Tatimi në pronë si një ndër kategoritë më të qëndrueshme të të hyrave të komunave dhe e cila konsiderohet si një e hyrë shumë e rëndësishme, viti 2015 ka pas ulje prej 2.4% nga viti 2014; ndërsa në vitin 2014 ka pas rritje për 26.6% nga viti 2013. Trendet e mbledhjes për periudhën 2013-2015 kanë rritje prej 23.5%. Marr në përgjithësi mesatarja për periudhën 2013-2015 është 12.1% (shih tabelën nr.2).

5.2 Të hyrat komunale për leje ndërtimi

Bazuar në të dhënat nga sistemi informativ i menaxhimit të financave të Kosovës kjo kategori e të hyrave prej vitit 2013 deri në vitin 2015 ka shënuar ulje prej 24.8%, do të thotë viti 2014 ka pas ulje për 30.3% nga viti 2013; viti 2015 ka pas rritje për 7.9% nga viti 2014. Mesatarja për periudhën 2013-2015 është 11.2% (shih tabelën nr.2).

5.3 Të hyrat nga ndërrimi i Destinimit të Tokës

Nga kategoria e të hyrave për Ndërrim të Destinimit të Tokës komunat e Republikës së Kosovës nga viti 2013 në vitin 2015 kanë pas rritje të mbledhjes për 27.7%, ku shikuar trendet sipas viteve në 2014 ka pas rritje prej 47.5% nga viti 2013; ndërsa viti 2015 ka pas ulje prej 13.4% prej vitit 2014. Mesatarja për periudhën 2013-2015 është prej 17.0% (shih tabelën nr.2).

5.4 Të hyrat nga veprimtaritë afariste

Nga kjo kategori mbledhja e të hyrave gjatë periudhës 2013 - 2015 ka pas ulje prej 14.3%; nga viti 2013 në vitin 2014 ka pas ulje prej 7.9%; ndërsa në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014 ka pasur ulje prej 7.0%.

Shikuar mesataren e periudhës 2013-2015 rezulton se është 7.4% (shih tabelën nr.2).

5.5 Të hyrat nga Dokumentet e Gjendjes Civile

Të dhënat në tabelën nr.1 tregojnë se në tre vitet e fundit është shënuar rritje në mbledhjen e këtyre të hyrave si në vijim: në vitin 2014 ka pasur rritje për 11.7% krahasuar me vitin 2013; në vitin 2015 prap ka pas rritje për 12.3% nga viti 2014; ndërsa trendi për periudhën 2013 - 2015 ka pas rritje prej 25.4%. Shikuar mesataren e viteve 2013-2015 rezulton të jetë 12.0%.

5.6 Të hyrat nga regjistrimi i automjeteve

Të dhënat nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës tregojnë se ka rritje të vazhdueshme në këtë kategori nga viti në vit me një mesatare prej 1.9%.

Viti 2014 krahasuar me vitin 2013 ka një rritje prej 0.2%; viti 2015 krahasuar me vitin 2014 ka rritje të inkasimit të këtyre të hyrave 3.6%; ndërsa trendi i mbledhjes për periudhën 2013 - 2015 ka pas rritje prej 3.8% (shih tabelën nr.2).

5.7 Të hyrat nga regjistrimi i trashëgimisë

Të hyrat e mbledhura në këtë kategori janë në ulje nga viti në vit me një mesatare prej 4.8%; me konkretisht krahasuar vitin 2014/2013 ky inkasim ka shënuar ulje për 1.4%; ndërsa krahasimi i vitit 2015/2014 tregon se mbledhja e këtyre të hyrave ka qenë prap në ulje prej 8.2%, gjithashtu viti 2015 krahasuar me 2013 ka shënuar ulje prej 9.5% (shih tabelën nr.2).

5.8 Të hyrat nga shfrytëzimi i pronës publike

Bazuar në të dhënat nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës kjo kategori e të hyrave në vitin 2014 ka shënuar rritje për 13.2% nga ajo e vitit 2013; pastaj në vitin 2015 ka pas ulje për (10.6%) nga viti 2014; ndërsa trendi i mbledhjes për periudhën 2013 - 2015 ka pas rritje prej 1.2%. Shikuar mesataren e krahasimit të viteve 2013-2015 rezulton të jetë 1.3%.

5.9 Të hyrat nga participimet në Arsim dhe Shëndetësi

Kjo kategori e të hyrave ka shënuar rritje në vitin 2014 për 0.9% nga viti 2013. Ndërsa viti 2015 tregon ulje për 3.9% nga viti 2014, dhe gjithashtu nëse krahasojmë vitin 2015 me vitin 2013 ka ulje për 3.1%. Mesatarja e kësaj periudhe është 1.5%.

5.10 Të hyrat tjera

Në kuadër të kësaj kategorie të të hyrave përfshihen të hyrat të cilat kanë pjesëmarrje më të vogël në të hyrat vetanake, për shembull: taksë për parkim publik, kampim dhe

rekreacion; taksa e pjesëmarrjes në tender; taksa për matjen e tokës në terren; të hyrat nga qeraja e objektit për banim; gjobat nga inspektorati; licenca për pranim teknik të lokalit; inspektimi higjieniko-sanitar; të hyrat nga shitja e mallrave, etj.

Këto të hyra në vitin 2014 kanë pasur ulje për (13.8%) nga vitit 2013; viti 2015 ka pasur rritje për 39.1% nga viti 2014, ndërsa trendi i mbledhjes për periudhën 2013 - 2015 është 20.0%. Shikuar mesataren 2013-2015 të kësaj lloji të hyres është 12.7% (shih tabelën nr.2).

6. Mbledhja e të hyrave vetanake krahasuar me planifikimin

Bazuar në planin vjetor të buxhetit dhe në rregulloren komunale për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunat gjatë vitit mbledhin të hyra si kundërvlerë për shërbimet e ofruara.

Të dhënat për periudhën 2013-2015 lidhur me realizimin e planit të të hyrave flasim për një mesatare prej 77.4%.

Realizimi i të hyrave vetanake krahas planifikimit për vitet 2013 është 82%, për vitin 2014 është 78% dhe për vitin 2015 është 72%.

Nëse krahasojmë realizimin e të hyrave krahas planifikimit për këtë periudhë në komuna atëherë viti 2014 ka pasur ulje për 4.3% nga vitit 2013; viti 2015 ka pasur prap ulje për 6.3% krahasuar me vitin 2014, ndërsa trendi për periudhën 2013-2015 ka rezultuar me ulje prej 10.5%.

Nëse analizojmë mesataren e realizimit për periudhën 2013-2015 sipas % së realizimit krahasuar me planifikimin e komunave atëherë shohim se 4 komuna kanë tejkaluar planin, pra mbi 100% , ndërsa nga 90% deri në 100% gjithashtu janë 4 komuna, dhe pjesa tjetër prej 30 komunave kanë një mesatare të realizimit nën 90%(shih tabelën nr.3).

Realizimi i të hyrave vetanake krahas planifikimit për vitet 2013-2014-2015														
Komunat	Viti 2013			Viti 2014			Viti 2015			Krahasimi 2014/13	Krahasimi 2015/14	Krahasimi 2015/13	Mesatarja	
	Planifikimi	Realizimi	% e realizimit	Planifikimi	Realizimi	% e realizimit	Planifikimi	Realizimi	% e realizimit					
1	2	3	4=3/ 2*100	5	6	7=6/ 5*100	8	9	10=9/ 8*100					
1	Gllgovc	1,000,000	782,834	78	1,050,000	1,250,864	119	1,200,874	829,262	69	53	-42	-12	-0.3
2	F.Kosovë	1,500,000	1,686,223	112	1,729,040	1,833,215	106	1,822,756	1,842,771	101	-5	-5	-10	-7
3	Lipjan	1,700,000	1,050,153	62	1,166,927	1,378,761	118	1,342,336	1,359,919	101	90	-14	63	46
4	Obiliq	794,000	791,586	100	735,000	1,013,161	138	811,716	1,032,731	127	38	-8	27	19
5	Podujevë	1,350,000	970,342	72	1,417,500	1,074,339	76	1,597,592	1,146,838	72	6	-5	0	0.1
6	Prishtinë	21,757,920	21,191,029	97	24,318,250	18,395,679	76	27,162,611	17,382,637	64	-22	-16	-34	-24
7	Shtime	390,000	283,040	73	409,500	311,277	76	445,503	351,232	79	4	4	8	5
8	Graçanicë	1,150,000	1,363,113	119	1,455,677	982,243	67	1,501,093	1,691,042	113	-44	69	-5	7
9	Dragash	420,000	325,826	78	441,000	318,520	72	487,030	305,637	63	-8	-13	-19	-13
10	Prizren	6,119,080	3,559,304	58	6,425,034	4,227,247	66	8,275,080	4,763,625	58	14	-12	0	1
11	Rahovec	950,000	726,765	77	997,500	776,899	78	1,099,014	841,935	77	1	-1	0	0.01
12	Suharekë	1,783,000	1,378,725	77	1,917,102	1,344,012	70	2,117,200	1,682,497	79	-9	13	3	2
13	Malishevë	750,000	519,841	69	787,500	803,953	102	755,908	524,886	69	48	-32	0	5
14	Damushë	60,000	39,937	67	63,000	52,122	83	64,889	48,306	74	24	-11	10	8
15	Deçan	600,000	391,668	65	630,000	381,358	61	636,892	586,132	92	-6	51	42	29
16	Gjakovë	2,900,000	2,185,418	75	3,045,000	2,332,645	77	3,026,311	2,320,751	77	3	0	3	2
17	Istog	900,000	738,091	82	945,000	751,067	79	1,014,149	795,964	78	-4	-1	-5	-3
18	Klinë	800,000	653,527	82	840,000	714,760	85	857,767	646,809	75	4	-12	-9	-6
19	Pejë	2,900,000	2,716,101	94	3,045,000	2,725,087	89	3,394,551	2,978,651	88	-5	-1	-6	-4
20	Junik	85,000	68,255	80	89,250	73,005	82	91,567	69,983	76	2	-7	-5	-3
21	Leposaviq	15,000	1,630	11	17,300	2,047	12	42,888	1,658	4	9	-67	-64	-40
22	Mitrovicë Juç	2,202,320	1,276,447	58	2,312,436	1,396,424	60	2,117,292	1,401,255	66	3	10	14	9
23	Skenderaj	750,000	592,976	79	599,777	700,173	117	748,155	607,149	81	48	-31	3	7
24	Vushtrri	1,550,000	1,116,743	72	1,652,000	1,239,415	75	1,675,327	1,327,155	79	4	5	10	6
25	Zubin Potok	15,000	3,607	24	15,750	1,205	8	42,888	1,403	3	-67	-63	-88	-72
26	Zveçan	10,000	393	4	12,400	4,157	34	42,888	867	2	750	-94	-50	202
27	Mitrovicë Ver	97,680	10,612	11	105,400	20,532	19	90,066	27,400	30	73	58	173	101
28	Gjilan	3,600,000	2,924,516	81	3,780,000	2,847,394	75	3,859,953	3,051,167	79	-7	5	-2	-2
29	Kaçanik	600,000	361,647	60	630,000	439,852	70	695,757	476,570	68	17	-3	13	9
30	Kamenicë	890,000	549,433	62	934,500	583,699	62	986,433	605,001	61	0	-2	-2	-1
31	Novobërdë	124,000	148,290	120	185,328	127,909	69	204,672	157,736	77	-43	12	-36	-22
32	Shtërpcë	290,000	136,163	47	304,500	224,740	74	336,282	203,829	61	57	-18	30	23
33	Ferizaj	3,926,000	2,565,358	65	3,807,300	2,880,545	76	4,204,689	3,117,047	74	17	-3	14	9
34	Viti	870,000	616,653	71	913,500	728,017	80	1,008,847	650,948	65	13	-19	-8	-5
35	Partesh	40,000	24,341	61	42,000	28,165	67	46,384	38,736	84	10	25	38	24
36	Hani i Elezit	350,000	242,658	69	242,949	259,662	107	256,258	214,333	84	55	-21	22	18
37	Kllokot	75,000	96,948	129	80,000	114,407	143	86,849	90,331	104	11	-27	-19	-12
38	Ranillugë	80,000	82,207	103	84,000	113,986	136	92,768	111,105	120	32	-12	17	12
	GJITHSEJ	63,394,000	52,172,402	82	67,226,420	52,452,540	78	74,243,215	53,285,295	72	-5	-8	-12	-8

Tabela 3. Paraqitja tabelare e realizimit të të hyrave krahas planifikimit në periudhën 2013 -2015 dhe trendet e rritjes/ zvogëlimit

7. Të hyrat indirekte të komunave

Institucionet e nivelit qendror inkasojnë të hyra për shërbimet e kryera në territorin e komunave. Të hyrat të cilat inkasohen nga niveli qendror si të hyrat nga dënimet e policisë, të hyrat nga dënimet e gjykatave dhe të hyrat nga prerja e pyjeve barten në

komuna varësisht në territorin e së cilës komunë janë inkasuar dhe përmes procesit të transferit alokohen në komuna për shfrytëzim të mëtejshëm.

Pasqyra e trendeve të të hyrave përfshirë të hyrat indirekte							
Të hyrat komunale	2013	2014	2015	% (2014/13)	% (2015/14)	% (2015/13)	mesatarja rritjes /zvogelimit
Të hyrat direkte	52,172,402.27	52,452,540.00	53,285,294.90	0.54	1.6	2.1	1.1
Të hyrat indirekte	3,677,928.52	8,477,687.00	5,078,910.50	130.5	-40.1	38.1	45.2
Gjithsej	55,850,330.79	60,930,227.00	58,364,205.40	9.1	-4.2	4.5	2.4

Tabela 4. Paraqitja tabelare e të hyrave direkte dhe të hyrat indirekte komunale

Siç mund të shihni trendet e të hyrave vetanake indirekte kanë rritje të theksuar në vitin 2014 për 130.5% nga viti 2013; viti 2015 ka ulje për 40.1% nga viti 2014; ndërsa krahasimi i periudhës 2013-2015 tregon rritje për 38.1%.

Nëse analizojmë totalin e të hyrave direkte dhe indirekte dhe krahasimi i tyre mes tre viteve 2013-2015, atëherë në vitin 2014 ka pas rritje prej 9.1% nga viti 2013, viti 2015 ka pasur ulje për 4.2% nga viti 2014, ndërsa trendi 2013-2015 gjithashtu tregon rritje prej 4.5%.

Mesatarisht periudha 2013-2015 ka rezultuar me rritje prej 2.4% (shih tabelën nr.4).

8. Bartja e të hyrave vatanake

Bartja e të hyrave është mjaft e madhe dhe ky fenomen përsëritet nga viti në vit sidomos bartja e vitit 2014 në vitin 2015 prej mbi 30 milion €, ndërsa ka një rënje të bartjes në vitin 2016 nga viti 2015 mbi 19 milion €, (shih tabelën nr.5).

Nr.	Komuna	Bartja nga viti 2012 në vitin 2013	Bartja nga viti 2013 në vitin 2014	Bartja nga viti 2014 në vitin 2015	Bartja nga viti 2015 në vitin 2016	Mesatarja e bartjes për tri vite
1	Glogoc	382,875	131,513	409,638	200,824	281,213
2	Fushë Kosovë	566,875	513,485	859,859	1,045,419	746,410
3	Lipjan	248,562	395,069	1,000,334	540,718	546,171
4	Obiliq	482,527	494,837	539,414	342,553	464,833
5	Podujevë	273,447	188,899	297,040	410,991	292,594
6	Prishtinë	21,326,799	14,612,163	17,893,989	7,280,641	15,278,398

7	Shtime	44,810	42,939	49,657	64,374	50,445
8	Gračanicë	646,760	622,189	328,761	454,988	513,175
9	Dragash	207,348	217,086	358,553	317,732	275,180
10	Prizren	1,114,900	883,066	1,848,423	1,524,455	1,342,711
11	Rahovec	194,162	168,163	281,748	247,857	222,983
12	Suharekë	1,364,123	385,768	580,453	441,937	693,070
13	Malishevë	358,333	155,898	236,941	142,922	223,524
14	Mamushë	66,427	30,478	74,994	66,557	59,614
15	Deçan	91,241	53,797	53,311	141,779	85,032
16	Gjakovë	335,359	297,907	384,494	614,448	408,052
17	Istog	168,280	188,922	411,741	218,134	246,769
18	Klinë	165,413	218,937	366,511	206,498	239,340
19	Pejë	769,957	665,510	711,878	1,183,637	832,746
20	Junik	19,617	19,116	23,850	16,457	19,760
21	Leposaviq	14,874	17,119	14,821	34,695	20,377
22	Mitrovicë	236,856	130,407	259,904	291,631	229,700
	Jugore					
23	Skenderaj	156,835	216,505	251,361	283,412	227,028
24	Vushtrri	440,227	417,272	493,421	459,300	452,555
25	Zubin Potok	8,018	11,765	11,751	6,882	9,604
26	Zveçan	635	1,353	16,454	20,734	9,794
27	Mitrovicë	21,832	11,944	7,872	15,089	14,184
	Veriore					
28	Gjilan	213,606	377,063	841,300	1,004,615	609,146
29	Kaçanik	174,415	121,480	152,163	142,981	147,760
30	Kamenicë	502,272	402,316	447,100	312,481	416,042
31	Novo Bërdë	70,285	26,625	92,711	69,174	64,699
32	Shtërpçë	95,728	48,410	85,929	54,785	71,213
33	Ferizaj	981,657	582,086	989,708	1,137,728	922,795
34	Viti	130,227	84,421	212,902	141,643	142,298
35	Partesh	24,357	24,991	55,646	44,326	37,330
36	Hani i Elezit	68,477	27,183	44,243	129,094	67,249
37	Klllokot	98,967	61,854	133,574	107,129	100,381
38	Ranillugë	66,315	43,418	68,366	49,889	56,997
	Gjithsejt:	32,133,398	22,891,954	30,890,815	19,768,509	26,421,169

Tabela 5. Bartja e të hyrave

9. Konkluzione dhe Rekomandime

Nga analiza e trendeve të të hyrave vetanake për periudhën 2013-2015 vërehet se ka një rritje prej 2.4% përfshirë edhe të hyrat indirekte ndërsa vetëm të hyrat direkte kanë rritje prej vetëm 1.1%.

Andaj nga të dhënat e këtyre trendeve konsiderojmë se disa çështje duhet të adresohen qoft nga niveli qendror ashtu edhe nga niveli lokal si:

- Mbledhja e të hyrave krahasuar me planifikimin në shumicën e komunave nuk është arritur gjë që duhet të mendohet për një planifikim më real. Pra qasja e komunave në planifikimin e të hyrave të bëhet më detal e në veçanti të rishikohet përlllogaritja e kostos së shërbimeve të ofruara për qytetarët.
- Të hyrat nga veprimtaritë afariste vazhdimisht nga viti në vit jan në ulje gjë që duhet të rishikohen vendimet e komunave për të rikthyer aplikimin kësaj takse.
- Komunitat në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të rishikojnë mundësitë e reja lidhur me një qasje më të avancuar në procesin e menaxhimit të grumbullimit të të hyrave nga tatimi në pronë.
- Komunitat kanë veshtirësi gjatë hartimit të rregulloreve për tarifa ngarkesa dhe gjopa në mungesë të informatave të ndyshimeve legislative nga niveli qendror kështu që niveli qendror duhet të bashkëpunojë më shumë me komuna dhe ti njoftoj komunitat me kohë për çdo ndryshim eventual me legjislacionin në fuqi.
- Komunitat nuk marrin ndonjë pjesë të taksave që niveli qendror i mbledh nga shfrytëzimi i të drejtave për miniera dhe gurthyes. Kështu që Ministria e Administrimit të Pushtit Lokal, Ministria e Financave dhe Komunitat e Republikës së Kosovës duhet të shqyrtojë mundësinë e ndarjes së këtyre të hyrave në bazë të prejardhjes së tyre.
- Bazuar në nevojën e madhe për investime në komuna dhe përkundër kërkesës së madhe për këto investime prapë bartja e të hyrave është një fenomen i shprehur dhe po përcillet nga viti në vit. Pra komunitat duhet të ndryshojnë këtë qasje lidhur me trajtimin e të hyrave të cilat do të duhet të investohen në ofrim të shërbimeve infrastrukturore për tatimpaguesit.

10. Referencat

1. Ligji Nr. 04/L-165 për buxhetin vjetor për vitin 2013;

2. Ligji Nr. 04/L-233 për buxhetin vjetor për vitin 2014;
3. Ligji Nr. 05/L-001 për buxhetin vjetor për vitin 2014;
4. Ligji Nr. 03/L-204 mbi tatimin në pronë;
1. Të dhënat nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave Publike - Ministria e Financave për vitin 2013;
2. Të dhënat nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave Publike - Ministria e Financave për vitin 2014;
3. Të dhënat nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave Publike - Ministria e Financave për vitin 2015.